



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT  
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



---

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK  
DEPARTMENT OF ECONOMY DEVELOPMENT – UPRAVA ZA EKONOMSKI RAZVOJ

---

# **RAPORTI I PUNËS**

---

## **JANAR-DHJETOR 2025**

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik  
Enver Shabani, drejtor

*Dhjetor, 2025*

---

## HYRJE

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka vazhduar realizimin e aktiviteteve sipas Planit të Punës së Drejtorisë dhe gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore kemi shënuar progres të jashtëzakonshëm sa i përket tërheqjes së investimeve dhe të realizimit të aktiviteteve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal dhe ngritjen e standardit të jetësës së qytetarëve të komunës së Gjilanit.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë muajit Janar – Dhjetor 2025 fokus të veçantë ju ka dhënë bashkëpunimit me donatorë, shoqërinë civile dhe të gjitha institucionet tjera te nivelit lokal e qendrore që prioritet e kanë Zhvillimin Ekonomik Lokal.

Ambiciet e tona janë që të ndërtojmë parakushte të mira për ardhje të investimeve në komunën e Gjilanit dhe për zhvillim sa më të shpejtë ekonomik të saj.

Gjatë kësaj periudhe kemi përmbyllë me suksesë monitorimin e fazës së tretë :**Fondi për Subvencionimin e Bizneseve Start-UP dhe bizneset e grave ndërmarrëse për vitin 2023** si kemi përmbyllë fazën e parë të monitorimit **Fondi për Subvencionimin e Bizneseve Start-UP dhe bizneset e grave ndërmarrëse për vitin 2024**.

Gjatë kësaj periudhe 12 mujore është hapur thirrja publike e tretë publike “**Fondi për Subvencionimin e Bizneseve Start-UP dhe bizneset e grave ndërmarrëse 2025** dhe kjo thirrje është mbyllur dhe janë zgjedhur përfituesit e kësaj thirrje dhe është fazën e implementimit të projekteve.

Ndërmarrësit e rinj dhe inovatorët me ide komerciale kanë mundësinë për t’u bërë pjesë e grantit po ashtu edhe bizneset Start-UP që do të fitojnë të drejtën për tu bërë pjesë e këtij programi.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka realizuar aktivitete të ndryshme dhe vizita përfshirë organizimin dhe pjesëmarrjen në punëtori ndryshme të organizuara nga organizata vendore dhe ndërkombëtare siç janë :Asociacioni i Komunave të Kosovës,Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, USAID , Swisscontact, Përfaqësues të KFOR-it Turk për Rajonin Lindje,Asociacioni Kosovar për Energji të Ripërtitshme dhe Eficiencë të Energjisë (AKEREE), Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Fondin e Kosoves për Eficiencë të Energjisë ,Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) OJQ të ndryshme si dhe vizita të ndërmarrjeve publike komunale dhe vizita bizneseve lokale.

Gjatë kësaj periudhe 12 mujore janë realizuar rreth 130 vizita në terren bizneseve, ndërmarrjeve publike, projekteve në realizim e sipër me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të ndryshme të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të Drejtorisë | Gjithashtu, janë mbajtur rreth 266 takime me palë të interesuara me ç’rast janë dhënë këshilla dhe udhëzime sipas kërkesave dhe nevojave të tyre në fushën e zhvillimit ekonomik si dhe në thirrjet publike për grante.

Gjatë kësaj periudhe 12 mujore **Drejtoria për Zhvillim Ekonomik** në bashkëpunim me **OJQ “Gruaja Hyjnore”** dhe **Drejtorinë e Bujqësisë dhe Oden Ekonomike-Dega Gjilan** ka organizuar pesë panaire në Komunën e Gjilanit:

***Panairi “Festo Tradicionalisht “ për nder të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës***



Tradita që zbukuron qytetin e Gjilanit | në 16 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Me dhjetëra stenda janë ngritur ne sheshin “Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha” ku janë ekspozuar punime të ndryshme tradicionale | si pjesë të traditës punime dhe prodhime nga dora e njeriut për këtë ditë të shënuar ku po dominojnë ngjyrat e kaltër, e verdhë e bardhe.


Kjo traditë e hershme në qytetin e bukur të Gjilanit nxjerr në pah punën dhe seriozitetin e artizanëve gjilanas të cilët ekspozojnë produktet e tyre duke tërhequr interesin e qytetarëve por edhe të turistëve, të cilët e vizitojnë Gjilanin në këto ditë feste .

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ne Gjilan, nëpërmjet këtij panairi, synohet stimulimin e një traditë e hershme e qytetit te Gjilanit, duke i ofruar çdo qytetari por edhe turisti produktin e traditës / Gjilani qyteti i tekstit!

---

## Panairi “Nënat Tona”

➤ për nder të festave 7 Marsi - Dita e Mësuesit dhe 8 Marsi - Dita e Gruas.



Dita Ndërkombëtare e Grave  
8 MARS

Panairi  
“NËNAT TONA”

Sheshi “Rexhep Mala e Nuhi Berisha”  
Gjiçan

Panairi ka pas qëllim prezantimin e punimeve artizanale si veshje kombëtare, produkte ushqimore tradicionale të punuara dhe të gatuar nga gratë ndërmarrëse të qytetit të Gjiçanit.

Ky panairi ka qenë i hapur dy ditë, i cili ishte i hapur me datat 7-8 Mars në sheshin “Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha”.

Drejtorja për Zhvillim Ekonomik ka ftuar të gjithë qytetarët e Komunës së Gjiçanit të jenë e pjesë e këtij panairi ku do të shohin për së afërmi produktet vendore të punuara nga gratë ndërmarrëse të Komunës së Gjiçanit.

Panairot si një veprim ekonomik ju ka shërbyer komunitetit dhe bizneseve si një takim, pasi është rasti me i mirë për të reklamuar mallrat dhe për t'u njohur me produktet e reja, rasti i mirë për të rritur prodhimin dhe për tu njohur me kërkesat e konsumatorit, rasti i mirë për shkëmbimin e informacioneve dhe ideve mbi produktet, rasti i mirë për të ofruar më shumë zgjedhje për konsumatorët.

## *Panairi "15 Qershori Dita e Çlirimit të Gjilanit "*

➤ *për nder të Çlirimit të Qytetit të Gjilanit*



*Qershor*  
**15** Dita e  
Çlirimit të  
Gjilanit

**Panairi**

**Gjilani jonë – dje  
histori, sot krenari!**



**Drejtoria për Zhvillim  
Ekonomik – Gjilan,  
Drejtoria e Bujqësisë,  
Ojq "Gruaja Hyjnore"**

**Sheshi "Rexhep Mala e Nuhi Berisha"  
Gjilan**

Panairi ka për qëllim prezantimin e punimeve artizanale si veshje kombëtare, produkte ushqimore tradicionale të punuara dhe të gatuar nga gratë ndërmarrëse të qytetit të Gjilanit.

Ky panairi ka qenë 3 ditor, i cili ka qenë i hapur me datat 13-14-15 Qershor në sheshin "Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha".

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka ftuar të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit të jenë e pjesë e këtij panairi ku do të shohin për së afërmi produktet vendore të punuara nga gratë ndërmarrëse të Komunës së Gjilanit.


## *Panairi "Anamorava mirëpret Diasporës"*

➤ për nder të Diasporës

dea



ODA EKONOMIKE KOSOVA CHAMBER  
OF COMMERCE E KOSOVËS



# Panairi "Anamorava mirëpret Diasporën"

Sheshi "Rexhep Mala e Nuhi Berisha"  
Gjiçan 7 dhe 8 Gusht 2025


Panairi ka për qëllim prezantimin e punimeve artizanale si veshje kombëtare, produkte ushqimore tradicionale të punuara dhe të gatuar nga gratë ndërmarrëse të qytetit të Gjiçanit.

Ky panairi ka qenë 2 ditor, i cili ka qenë i hapur me datat 7 dhe 8 Gusht në sheshin "Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha".

Drejtorja për Zhvillim Ekonomik ka ftuar të gjithë qytetarët e Komunës së Gjiçanit të jenë e pjesë e këtij panairi ku do të shohin për së afërmi produktet vendore të punuara nga gratë ndërmarrëse të Komunës së Gjiçanit.

## *Panairi "Forco Traditen"*

➤ *për nder të 28 Nëntorit "Ditës së Flamurit"*



**Festa e Flamurit dhe  
113-vjetori i Pavarësisë  
së Shqipërisë**



**Drejtoria për Zhvillim  
Ekonomik - Gjilan**



**Panairi  
"Forco Traditën"**

**Sheshi "Rexhep Mala e Nuhi Berisha"  
Gjilan**

Panairi tradicional Forco Traditën, është një aktivitet që synon të promovojë dhe ruajë trashëgiminë kulturore, traditat dhe produktet vendore të Komunës së Gjilanit.

Panairi gjithashtu ka për qëllim të fuqizojë gratë dhe bizneset e vogla, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të komunës.


Ky panair u zhvillua me rastin e Festave të Nëntorit dhe ofron një mundësi për artizanalet, prodhuesit lokalë dhe fermerët që të prezantojnë produktet e tyre.

**Qendra për Regjistrimin e Bizneseve** | gjatë periudhës 12 mujore Janar-Dhjetor 2025 janë regjistruar 716 biznese të reja dhe të punësuar rreth 1268 punëtorë ndërsa janë shuar 84 biznese me rreth 116 puntorë.

Në bazë të dhënave nga Qendra për Regjistrimin e Bizneseve kemi një trend pozitiv të regjistrimit të bizneseve të reja dhe numrin e puntorëve.

| Përshkrimi         | Janar     | Shkurt    | Mars      | Prill     | Maj       | Qershor   | Korrik     | Gusht     | Shtator   | Tetor     | Nëntor    | Dhjetor   | Totali     |
|--------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|
| Prodhuese          | 8         | 6         | 10        | 2         | 8         | 9         | 16         | 10        | 8         | 4         | 9         | 9         | 99         |
| Tregtare           | 11        | 8         | 15        | 15        | 13        | 16        | 23         | 9         | 11        | 16        | 16        | 11        | 164        |
| Shërbyese          | 22        | 17        | 21        | 34        | 49        | 36        | 53         | 24        | 33        | 33        | 20        | 53        | 395        |
| Ndërtimore         | 4         | 5         | 7         | 5         | 8         | 0         | 10         | 2         | 4         | 5         | 6         | 2         | 59         |
| <b>Gjithësejt:</b> | <b>45</b> | <b>36</b> | <b>53</b> | <b>56</b> | <b>78</b> | <b>61</b> | <b>102</b> | <b>45</b> | <b>56</b> | <b>58</b> | <b>51</b> | <b>75</b> | <b>716</b> |
| Pronare femra      | 4         | 12        | 4         | 15        | 12        | 15        | 31         | 5         | 20        | 8         | 15        | 17        | 158        |
| Pronar meshkuj     | 41        | 35        | 49        | 41        | 66        | 45        | 71         | 40        | 36        | 50        | 62        | 58        | 584        |
| Numri i punëtorve  | 94        | 89        | 92        | 107       | 134       | 128       | 145        | 67        | 95        | 99        | 77        | 141       | 1268       |
|                    |           |           |           |           |           |           |            |           |           |           |           |           |            |
| Prodhuese          | 1         | 0         | 1         | 0         | 1         | 6         | 2          | 1         | 0         | 1         | 0         | 1         | 14         |
| Tregtare           | 2         | 0         | 3         | 3         | 1         | 0         | 2          | 2         | 0         | 3         | 2         | 4         | 22         |
| Shërbyese          | 5         | 3         | 7         | 4         | 8         | 0         | 0          | 2         | 2         | 6         | 2         | 4         | 43         |
| Ndërtimore         | 0         | 0         | 1         | 0         | 1         | 0         | 0          | 0         | 1         | 1         | 1         | 0         | 5          |
| <b>Gjithësejt:</b> | <b>8</b>  | <b>3</b>  | <b>12</b> | <b>7</b>  | <b>11</b> | <b>6</b>  | <b>4</b>   | <b>5</b>  | <b>3</b>  | <b>11</b> | <b>5</b>  | <b>9</b>  | <b>84</b>  |
| Pronar meshkuj     | 7         | 2         | 11        | 7         | 10        | 6         | 3          | 3         | 3         | 9         | 4         | 7         | 72         |
| Pronare femra      | 1         | 1         | 1         | 0         | 1         | 0         | 1          | 2         | 0         | 2         | 1         | 2         | 12         |
| Numri i punëtorve  | 8         | 7         | 12        | 10        | 21        | 10        | 3          | 8         | 4         | 11        | 7         | 15        | 116        |

Skema



**Sektori i Eficiencës së Energjisë :** Një tjetër sektor i rëndësishëm i kësaj drejtorie është edhe Eficienca e Energjisë.

#### **OBJEKTET EDUKATIVO ARSIMORE**

1. SHFMU “ Rexhep Elmazi “ në Gjilan.

Marrëveshja për Shërbime të Energjisë më qëllim të zbatimit të masave të eficiencës së Energjisë është nënshkruar me datë 25.02.2022 në vlerë prej 158,247.47 €, pastaj Aneks-Marrëveshje e datës 27.05.2023 në vlerë prej 155,814.24 €.

2. SHMT “ Mehmet Isai “ në Gjilan.

Marrëveshja për Shërbime të Energjisë më qëllim të zbatimit të masave të eficiencës së Energjisë është nënshkruar me datë 25.02.2022 në vlerë prej 196,861.39 €, pastaj Aneks-Marrëveshje e datës 27.04.2023 në vlerë prej 224,290.86 €

3. SHFMU “ Abaz Ajeti “ Gjilan

Marrëveshja për Shërbime të Energjisë më qëllim të zbatimit të masave të eficiencës së Energjisë është nënshkruar me datë 25.01.2023 në vlerë prej 349,993.77 €,

#### **NDËRTESAT PUBLIKE KOMUNALE**

Mbledhja dhe përpunimi i shënimeve lidhur me shpenzimet energjetike :

1. Faturat e energjisë elektrike për vitin 2024. (€ / kWh)
2. Faturat e ujit për vitin 2024 (€/ m3)
3. Faturat për lëndë djegëse (dru,pelet,naftë e të tjera) për 2024.

Ekziston një formularë i veçant i kalkulimit dhe përditësimit të këtyre të dhënave e që duhet plotësuar nga zyrtarët përkatës.

#### **OBJEKTET BANESORE SOCIALE**

Marrëveshje e bashkëfinancimit ndërmjet FKEE dhe Komunës së Gjilanit 2021/24 datë 21.11.2024 lidhur me : Zbatimi i masave eficiente të energjisë në ndërtesën shumë banesore sociale (hyrja A dhe B).

Shuma e bashkëfinancimit të projektit është 240,522.55 €(100%) nga të cilat :

216,470.30 € (90%) financohet nga FKEE.

24,052.26 € (10%) financohet nga Komuna e Gjilanit.

**Ky projekt ka përfunduar me sukses.**

## Fondi për Ndërmarrësit e Rinjë

(Monitorimi i fazës së tretë për përfituesit e granteve në vitin 2023)

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore ka realizuar monitorimin e përfituesve të granteve për vitin 2023 (faza e tretë) tek secili biznes përfitues me qëllim të verifikimit të gjendjes në teren dhe për t'u siguruar se janë duke u zbatuar projektet (pjesë përbërëse) sipas kontratës.

Monitorimi i përfituesve të granteve për fazën e tretë të vitit 2023 është kryer me qëllim të vlerësimit të mënyrës së përdorimit të fondeve dhe ndikimit të tyre në zhvillimin ekonomik lokal.

Granti ka ndihmuar në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Në disa raste është vërejtur nevoja për mbështetje shtesë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që përballen me sfida në treg.

| Përshkrimi   | Femra | Meshkuj | Gjithsejtë |
|--------------|-------|---------|------------|
| Sipas listës | 38    | 7       | 45         |

*Pjesë e regjistratorit / lista e përfituesve!*

### Skema 2 / sektorët përfitues nga programi

| Përshkrimi i pajisjeve                       | Numri i përfituesve |
|----------------------------------------------|---------------------|
| Robaqepësi                                   | 16                  |
| Fotografë                                    | 5                   |
| Prodhim Elektrike dhe drurit                 | 1                   |
| Arkitekture                                  | 2                   |
| Sallon Ondulimi                              | 6                   |
| Shërbime të kontabilitetit                   | 1                   |
| Shëndeti njeriut                             | 1                   |
| Prodhimi i Stolive (arit, argjendit) Zejtari | 1                   |
| Marketing dhe web faqe                       | 2                   |
| Prodhimi dhe lyerja e xhamave                | 1                   |
| Shërbime të avokatisë                        | 1                   |
| Shërbime të pastrimit gjeneral               | 1                   |
| Shërbime të ndërtimit                        | 1                   |
| Shërbime të instalimit (ujë, ngrohje, ajër)  | 2                   |
| Automekanik                                  | 1                   |
| Prodhimi dhe përpunimi i mishit              | 1                   |
| Prodhimi produkteve nga brumi                | 1                   |
| Shërbime lulishte, bimë                      | 1                   |

### **Monitorimi i përfituesve të granteve për vitin 2024 (faza e parë):**

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore ka realizuar monitorimin e përfituesve të granteve për vitin 2024, në fazën e parë të zbatimit të projekteve.

Ky proces ka pasur për qëllim vlerësimin e ecurisë së realizimit të projekteve të mbështetura financiarisht nga Komuna e Gjilanit, përmes vizitave në terren dhe raportimit të rregullt nga ana e bizneseve përfituese.

Monitorimi ka ndihmuar në identifikimin e sfidave, vlerësimin e ndikimit fillestar të mbështetjes dhe garantimin e përdorimit të drejtë të fondeve publike.

#### ***Skema 1 / gjinia e përfituesve***

| <b>Përshkrimi</b>   | <b>Femra</b> | <b>Meshkuj</b> | <b>Gjithsej</b> |
|---------------------|--------------|----------------|-----------------|
| <i>Sipas listës</i> | 23           | 5              | 28              |

*Pjesë e regjistrorit / lista e përfituesve!*

#### ***Skema 2 / sektorët përfitues nga programi***

| <b><i>Përshkrimi i sektorëve</i></b>          | <b><i>Numri i përfituesve</i></b> |
|-----------------------------------------------|-----------------------------------|
| <i>Prodhim i veshjeve</i>                     | 9                                 |
| <i>Prodhim të akullit</i>                     | 1                                 |
| <i>Shërbim të IT-së</i>                       | 2                                 |
| <i>Arkitekturë</i>                            | 3                                 |
| <i>Sallon Ondulimi</i>                        | 2                                 |
| <i>Marketing dhe web faqe</i>                 | 2                                 |
| <i>Shërbime të dekorit</i>                    | 2                                 |
| <i>Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve</i> | 1                                 |
| <i>Shërbime të pastrimit gjeneral</i>         | 3                                 |
| <i>Prodhimi i vajrave</i>                     | 1                                 |
| <i>Shërbime artistike</i>                     | 1                                 |
| <i>Prodhim i ëmbësirave</i>                   | 1                                 |

*Bazuar në të dhënat nga lista dhe vizita në teren!*



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore të vitit 2025 ka hapur thirrjen e tretë publike për të gjithë bizneset Start-up dhe biznese në pronësi të grave ndërmarëse për mundësin e përfitimit të granteve nga "FONDI PËR SUBVENCIONIMIN E BIZNESEVE START-UP DHE BIZNESET EKZISTUESE TË GRAVE 2025 " të mbështetur nga Komuna e Gjiçanit.

Kjo thirrje publike ka për synim kryesor zhvillimin e ekonomisë lokale përmes mbështetjes për bizneset ekzistuese dhe krijimin e bizneseve të reja duke ofruar mbështetje në ngritjen e kapaciteteve për bizneset ekzistuese dhe avancime të reja teknologjike në pajisje dhe makineri të nevojshme në procesin e punës.

Vlera e buxhetit të thirrjes publike për subvencionimin e bizneseve Start Up dhe Bizneset ekzistuese të Grave për vitin 2025 është 150,000 €.

Gjatë kësaj periudhe 12 mujore janë përzgjedhur përfituesit e granteve në thirrjen publike "Fondi për subvencionimin e bizneseve Start-up dhe Bizneset ekzistuese të grave 2025.

Numri i përfituesve në këtë thirrje publike është : 51 përfitues

**Start up : 33 përfitues**

**Biznese ekzistuese : 18 përfitues**

Fondi për subvencionimin e bizneseve Start-up dhe Bizneset ekzistuese të grave 2025 është në fazën e implementimit të projekteve nga përfituesit.

Gjatë vitit të ardhshëm do të fillojë faza e monitorimit për tri vitet : vitin 2023 (faza e fundit) , vitin 2024 (faza e dytë), vitin 2025 (faza e parë).

Buxheti i planifikuar për vitin 2026 për Fondin për subvencionimin e bizneseve Start-up dhe Bizneset ekzistuese të grave është 250,000 €.

## Investimet Kapitale

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka vazhduar realizimin e aktiviteteve sipas planit të punës së Drejtorisë dhe gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore kemi shënuar progres të jashtëzakonshëm sa i përket tërheqjes së investimeve dhe të realizimit të aktiviteteve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal dhe ngritjen e standardit të jetesës së qytetarëve të komunës së Gjilanit.

Sa i përket investimeve kapitale, **janë gjithsej 13 projekte të reja infrastrukturë publike dhe sociale** të cilat do të realizohen në bashkë-financim me Komunën e Gjilanit dhe me mbështetjen financiare nga niveli qendror (MMPH, ME, MKRS, MFPT, MZHR, FKKE, Islamic Relief) dhe donatorë (QATAR CHARITY, Islamic Relief Kosova, Advancing Together etj) të cilat kapin **vlerën prej 17,674,655.46 (€)**.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të bashkë-financoj projektet prioritare **në vlerën prej 2,028,855.62 (€)** nga të cilat **15,645,799.84 (€)** do të financohen nga donatorët.

Disa prej projekteve të investimeve kapitale sipas Marrëveshjeve me donatorë janë planifikuar të realizohen për periudhën dy-vjeçare dhe priten të përfundojnë në vitin 2025-2026 si në vijim projektet:

1. Kult Qendra / në lagjen Dardania
2. Zgjerimi dhe Asfaltimi i rrugës "Hamdi Kurteshi"
3. Palestra e sporteve "Bashkim Selishta"
4. Impianti për trajtimin e ujrave të zeza-Gjilan

Ndërsa punimet që janë duke vazhduar për realizimin e tri projekteve të bartura nga viti paraprak 2023-2024 siç janë :

Asfaltimi i rrugës në fshatin Haxhaj,

Terrenet sportive

Kanalizimi fekal Livoq i Poshtëm - Livoq i Epërm - Lagjja Kodra e Thatë

Gjatë kësaj periudhe 12 mujore ka filluar ndërtimi i projektit **"Ndërtimi i Stacionit të Autobusave -Gjilan "** në bashkëpunim në mes Komunës së Gjilanit dhe Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokalë (MAPL) e cila bashkëfinancon **90,000 €** kurse pjesën tjetër Komuna e Gjilanit me vlerë **1,046,010.34** , ku vlera e përgjithëshme këtij projekti është **1,136,010.34 €** dhe kohëzgjatja e përfundimit të këtij projekti është për dy vite **2025-2026**.

Skema e projekteve dhe të dhënave tjera | Investimet Kapitale

| Nr           | Projekte të investimeve kapitale<br>përmes kodit të<br>bashkëfinancimit gjatë vitit<br>2024-2025 | Donatori | Vlera e<br>Projektit | Financimi<br>nga<br>Donatori | BF nga<br>DZHE/Komun<br>a | Koment                                                                                                                         |
|--------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|----------------------|------------------------------|---------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1            | Kult Qendra                                                                                      | MZHR     | 1,186,511.11         | 1,056,511.11                 | 130,000.00                | Është në ekzekutim të Punëve(vazhdojnë punimet) dhe pagesat bëhen nga Ministra.                                                |
| 2            | Asfaltimi i rrugës "Hamdi Kurteshi"                                                              | MMPHI    | 2,365,834.81         | 2,365,834.81                 |                           | Është në ekzekutim të Punëve(vazhdojnë punimet) dhe pagesat bëhen nga Ministra.                                                |
| 3            | Ndërtimi i Stacionit të Autobusëve<br>në Komunën e Gjilanit                                      | MAPL     | 1,036,010.34         | 90,000.00                    | 1,003,423.20              | Është në ekzekutim të Punëve(vazhdojnë punimet) të gjitha pagesat duhet të bëhen nga K.Gjilanit sipas Kontratës 1,003,423.20 € |
| 4            | Palestra e sporteve "Bashkim<br>Selishta"                                                        | MKRS     | 2,400,000.00         | 2,000,000.00                 | 400,000.00                | Është në ekzekutim të Punëve(vazhdojnë punimet)                                                                                |
| 5            | Projekti Smart City (Neutral Host)                                                               | ME       | 450,000.00           | 250,000.00                   | 200,000.00                | Është në proces të zhvillimit procedurave për realizim                                                                         |
| 6            | SH.F.M.U."Abaz Ajeti" Gjilan                                                                     | FKEE     | 24,999.56            |                              | 24,999.56                 | Ky projekt ka përfunduar dhe është në proces të pagesave                                                                       |
| 7            | SH.F.M.U."Rexhep Elmazi" Gjilan                                                                  | FKEE     | 11,140.72            |                              | 11,140.72                 | Ky projekt ka përfunduar dhe është në proces të pagesave                                                                       |
| 8            | SH.M.T."Mehmet Isai" Gjilan                                                                      | FKEE     | 16,036.82            |                              | 16,036.82                 | Ky projekt ka përfunduar dhe është në proces të pagesave                                                                       |
| 9            | Impianti për trajtimin e<br>ujërave të zeza-Gjilan                                               | MFPT     | 3,125,014.00         | 3,125,014.00                 |                           | Është në proces të zhvillimit procedurave të tenderimit nga MFPT dhe "Hidromorava"                                             |
| 10           | Asfaltimi Rrugës në fsh.Kokaj<br>(Rruga Llovcë - Ranatovcë)                                      | MMPHI    | 569,135.37           | 3,69135.37                   | 200,000.00                | Është në ekzekutim të Punëve(vazhdojnë punimet)                                                                                |
| 11           | Ndërtesat shumë banesore sociale<br>I hyrja A dhe B                                              | FKEE     | 240,522.55           | 216,470.30                   | 24,052.26                 | Është në ekzekutim të Punëve(vazhdojnë punimet) vlera e K.Gjilanit eshte paguar                                                |
| 12           | Ndërtesat shumë banesore sociale<br>II hyrja A dhe B                                             | FKEE     | 192,038.05           | 172,834.25                   | 19,203.06                 | Është në ekzekutim të Punëve (vazhdojnë punimet) vlera e K.Gjilanit eshte paguar                                               |
| 13           | Ndërtimi i Qarkores së Gjilanit                                                                  | MMPHI    | 6,000,000.00         | 6,000,000.00                 |                           | Nuk kemi informacion nëse janë zhvilluar procedurat                                                                            |
| Gjithsejtë : |                                                                                                  |          | 17,674,655.46        | 15,645,799.84                | 2,028,855.62              |                                                                                                                                |

**AKTIVITETET E REALIZUARA**

Në tabelën e mëposhtme gjeni Raportin e Planifikimit fillestar të vitit 2025 dhe Shpenzimet e Drejtorisë të periudhës Janar-Dhjetor 2025. Realizimi i shpenzimeve financiare me përqindje për periudhën dymbëdhjetë mujore 2025 është 93.63 % sipas planifikimit të shpenzimeve.

**RAPORT I SHPENZIMEVE / Janar - Dhjetor/ 2025**

| Planifikimi Fillestar - 2025 |                      |                   |                   |            |                     |                    |             |                    |                                |              |
|------------------------------|----------------------|-------------------|-------------------|------------|---------------------|--------------------|-------------|--------------------|--------------------------------|--------------|
| Drejtoritë/Programet         | Drejtoritë Programet | Numri i puntoreve | Fondi Burimor     | Pagat      | Mallra dhe sherbime | Shpenzime komunale | Subvencione | Shpenzime kapitale | Rezervat sipas Ligjit buxhetit | Gjithësejt € |
| Zhvillim Ekonomik            | 480/48027            | 13                | Granti Qeveritar  | 115,216.00 | 50,000.00           | 2,000.00           | 50,000.00   | 1,601,986.00       | -                              | 1,819,202.00 |
|                              |                      |                   | Të Hyrat Vetanake |            |                     |                    | 100,000.00  |                    |                                |              |
| Gjithësejt €                 |                      |                   |                   | 115,216.00 | 50,000.00           | 2,000.00           | 150,000.00  | 1,601,986.00       | -                              | 1,819,202.00 |

| Alokimi i Buxhetit - 2025 |           |    |                   |            |           |          |            |            |           |              |
|---------------------------|-----------|----|-------------------|------------|-----------|----------|------------|------------|-----------|--------------|
| Zhvillim Ekonomik         | 480/48027 | 13 | Granti Qeveritar  | 103,002.22 | 95,000.00 | 2,000.00 | 84,000.00  | 820,000.00 | -         | 1,104,002.22 |
|                           |           |    | Të Hyrat Vetanake |            |           |          | 41,000.00  |            | 41,000.00 |              |
| Gjithësejt €              |           |    |                   | 103,002.22 | 95,000.00 | 2,000.00 | 125,000.00 | 820,000.00 | -         | 1,145,002.22 |

| Shpenzimet - 2025                                                  |                      |                   |                   |            |                     |                    |             |                    |                                |              |
|--------------------------------------------------------------------|----------------------|-------------------|-------------------|------------|---------------------|--------------------|-------------|--------------------|--------------------------------|--------------|
| Drejtoritë/Programet                                               | Drejtoritë Programet | Numri i puntoreve | Fondi Burimor     | Pagat      | Mallra dhe sherbime | Shpenzime komunale | Subvencione | Shpenzime kapitale | Rezervat sipas Ligjit buxhetit | Gjithësejt € |
| Zhvillim Ekonomik                                                  | 480/48027            | 13                | Granti Qeveritar  | 103,002.22 | 57,188.07           | 1,450.96           | 49,969.20   | 819,998.05         |                                |              |
|                                                                    |                      |                   | Të Hyrat Vetanake |            |                     |                    | 40,470.98   |                    |                                |              |
| Gjithësejt €                                                       |                      |                   |                   | 103,002.22 | 57,188.07           | 1,450.96           | 90,440.18   | 819,998.05         |                                | 1,072,079.48 |
| Shpenzimet Shprehur në %                                           |                      |                   |                   | 100.00     | 60.20               | 72.55              | 72.35       | 100.00             |                                | 93.63        |
| Vetem te Zotuara                                                   |                      |                   |                   |            | 1,500.00            | -                  | -           | -                  |                                | 1,500.00     |
| Shpenzimi + Zotimi                                                 |                      |                   |                   | 103,002.22 | 58,688.07           | 1,450.96           | 90,440.18   | 819,998.05         | -                              | 1,073,579.48 |
| Shpenzimet + Zotimet Shprehur ne %                                 |                      |                   |                   | 100.00     | 61.78               | 72.55              | 72.35       | 100.00             |                                | 93.76        |
| TË LIRA - SALDO (të pa shpenzuara)                                 |                      |                   |                   | -          | 36,311.93           | 549.04             | 34,559.82   | 1.95               | -                              | 71,422.74    |
| VENDIMET GJYQËSORE TË EKZEKUTUARA NGA THESARI (MFPT)               |                      |                   |                   |            | 9,000.00            |                    | 49,955.00   | 410,000.00         |                                | 468,955.00   |
| Sipas Planit te Zotimit nga Granti per periudhen Janar- Dhjetor    |                      |                   |                   |            |                     |                    |             |                    |                                |              |
| Sipas Planit te Shpenzimit nga Granti per periudhen Janar- Dhjetor |                      |                   |                   |            |                     |                    |             |                    |                                |              |

## Inkubatori i Biznesit

| Numër | Shfrytëzuesi aktual                          |     | Hapësirat m <sup>2</sup> | Dokumentacioni ligjor                              | Afati   | Lokacioni    |
|-------|----------------------------------------------|-----|--------------------------|----------------------------------------------------|---------|--------------|
| 1     | Kujdestaria Ministria e Bujqësisë-AKP        | MB  | 4m <sup>2</sup>          | Memorandum Komuna - A. Pyjor Kosovës               | Aktive  | Kati përdhes |
| 2     | APK – tekniket e Pyjeve të Bartur nga Komuna | AP  | 43.16m <sup>2</sup>      | Memorandum Komuna - Agjencia e Pyjeve              | Aktive  | Kati përdhes |
| 3     | Shoqata “Cormoran”-Gjilan                    | KB  | 30.59m <sup>2</sup>      | Memorandum me zyrën e Kryetarit                    | aktive  | Kati përdhes |
| 4     | Shoqata e peshkatreve -Gjilan                | KB  | 30.59m <sup>2</sup>      | Memorandum me zyrën e Kryetarit                    | aktive  | Kati përdhes |
|       | Hapësirë Private                             | HP  |                          | Qendër tek.e IPKO                                  |         | Kati përdhes |
|       | Hapësirë Private                             | HP  |                          | Qendër tek. e IPKO                                 |         | Kati përdhes |
| 7     | OJQ”Fuqia e Bashkimit Rinorë”                | MB  | 43.16                    | Marreveshje mirëkuptimi: OJQ- me Zyren e Kryetarit | Aktiv   | Kati Parë    |
|       | Hapësirë private                             | HP  |                          | Qendër solariumi                                   |         | Kati i Parë  |
|       | Hapësirë private                             | HP  |                          | Qendër e kurseve                                   |         | Kati i Parë  |
| 8     | OJQ Gjilan- salla e praktikës                | OJQ | 8m <sup>2</sup>          | Memorandum Komuna - TIK-a                          | Aktive  | Kati i Parë  |
| 8/A   | OJQ Gjilan - Administrata e Shoqatës         | OJQ | 6m <sup>2</sup>          | Memorandum me zyrën e Kryetarit                    | Aktive  | Kati i Parë  |
| 8/A1  | OJQ Gjilan- salla e trajnimit                | OJQ | 16m <sup>2</sup>         | Memorandum me zyrën e Kryetarit                    | Aktive  | Kati i Parë  |
| 10    | Shoqata NPL”Tregu”                           | OJQ | 30.59m <sup>2</sup>      | Marrëveshje NPL Tregu dhe Z.Kryetarit              | Aktive  | Kati i Parë  |
| 11    | Ministria e Bujqësisë/ Agjesioni Pyjor       | MB  | 28m <sup>2</sup>         | Memorandum Komuna – Agjensioni Pyjor Kosoves       | Aktive  | Kati i Parë  |
| 12    | KK-Arkiva e Prokurimit                       | KK  | 57.21m <sup>2</sup>      | KK-Zyra e Prokurimi Gjilan                         | Mbyllur | Kati i dytë  |
|       | Hapësirë Private                             | HP  |                          | Qendër e kurseve gj. te huaja                      |         | Kati i dytë  |

|    |                                                      |                 |                     |                                                           |                         |              |
|----|------------------------------------------------------|-----------------|---------------------|-----------------------------------------------------------|-------------------------|--------------|
|    | Hapësirë Private                                     | HP              |                     | Banim familjar                                            |                         | Kati i dytë  |
| 13 | “OJQ” Psikoterapeutët në veprim                      | OJQ             | 35.49m <sup>2</sup> | Marrëveshje OJQ Psikoterapeutet dhe Z.Kryetarit           | Aktive                  | Kati i dytë  |
| 14 | Shoqata e grave Turko-Shqiptare "Fidan"              | OJQ             | 48.33m <sup>2</sup> | Në proces të aprovimit sipas kërkesës të Zyra e Kryetarit | Proces Kërkesë (Pasive) | Kati i dytë  |
| 15 | Shoqata e grave artizanale “ZOJA”-Gjilan             | IB              | 37m <sup>2</sup>    | Memorandum me zyra e Kryetarit                            | Aktiv                   | Kati i dytë  |
| 16 | Shoqata e TMK-së "ELITA"                             | OJQ             | 27.76m <sup>2</sup> | Marrëveshje shoqata ELITA dhe zyra e Kryetarit            | Aktiv                   | Kati i dytë  |
| 17 | APK – punetore administrat tekniket e Pyjeve -Gjilan | Org.stu dentore | 46m <sup>2</sup>    | Memorandum me zyra e Kryetarit                            | Aktiv                   | Kati i tretë |
|    | Hapësirë korridori për nevoja të APK-së              | MB              |                     | Shfrytëzim të APK-së, Arhivë                              |                         | Kati i tretë |
|    | Hapësirë private                                     | HP              |                     | Hapësirë e hapur private                                  |                         | Kati i tretë |
| 18 | Organizata Studentore “SKV”-                         | MB              | 34m <sup>2</sup>    | Memorandum Zyra e Kryetarit dhe Agjensioni Pyjeve -Gjilan | Aktiv                   | Kati i tretë |
| 19 | Organizata për mbrojtjen e grave “LIRIA”             | OJQ             | 30.59m <sup>2</sup> | Marrëveshje Mirekuptimi OMG“LIRIA” dhe zyra Kryetarit     | Aktive                  | Kati i tretë |
| 20 | Ministria Bujqësisë Agjensioni Pyjeve njësi - Gjilan | MB              | 28m <sup>2</sup>    | Memorandum Komuna - A. Pyjor                              | Aktive                  | Kati i tretë |
| 21 | Ministria e Bujqësisë Agjensioni Pyjeve-Gjilan       | MB              | 37m <sup>2</sup>    | Memorandum KK-Gjilan                                      | Aktive                  | Kati i tretë |

Komuna e Gjilanit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me biznese lokale, organizata joqeveritare :

Në periudhën 12 mujore Janar-Dhjetor 2025 janë nënshkruar : **10 marrëveshje.**

Gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka zhvilluar bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të ngushtë me ministrinë e linjës, me qëllim të rritjes së efikasitetit në zbatimin e projekteve zhvillimore, harmonizimit të politikave lokale me ato qendrore si dhe përfitimit të mbështetjes financiare dhe teknike në fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik.

Bashkëpunimi është konkretizuar përmes pjesëmarrjes në takime koordinuese, konsultimeve për hartimin e strategjive dhe planeve vepruese, dorëzimit të projekteve për financim, si dhe përmes shkëmbimit të vazhdueshëm të informatave dhe dokumentacioneve për temat me interes të përbashkët.

Kjo qasje ka ndihmuar në avancimin e agjendës së zhvillimit lokal dhe ka mundësuar qasje më efektive në resurset që ofrohen nga niveli qendror

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka bashkëpunuar ngushtë me :

- NPL “Tregu”,
- NPL “Stacioni i Autobusëve” dhe
- PPP “Eco-higjiena”

Drejtoria do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë dhe është në kërkim të partneriteteve me të gjithë akterët relevant në nivel lokal dhe qendror, donatorë, shoqëri civile, komunitet të biznesit, me qëllim të koordinimit të iniciativave dhe aktiviteteve të cilat ndikojnë në rigjenerimin ekonomik, rritjen ekonomike si dhe përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së jetesës së qytetarëve.

*Enver Shabani*

---

**Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik**